

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME SHKODËR SH.A

SEKTORI I BURIMEVE NJEREZORE

SHPALLJE PER VENDE TE LIRA PUNE

Bazuar ne Ligjin 7961, date 12.07.1995 “Kodi i Punes i Republikes se Shqiperise” (i ndryshuar), mbështetur në Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare” të ndryshuar, Vendimit te Këshillit te Ministrave nr. 302, date 11.05.2022 “Politikat Kombëtare për Riorganizimin e Sektorit te Furnizimit me Ujë të Largimit të Ujrave te Ndotura”, Statutit të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Qarku Shkodër sh.a. Vendimin Nr.11. datë 06.06.2024 “Për Miratimin e Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a”, Vendimit nr.9 date 18.12.2025, “Keshillit Mbikqyres”, Për miratimin e organigramës dhe nivelit te pagave për punonjësit e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a, shpallen procedurat e konkurimit per vend te lire pune:

1(nje) Punonjes Kolektoresh KUZ Shkoder

Detyrat dhe pergjegjesite kryesore

Punëtori i Sektorit të Kanalizimeve varet nga Përgjegjësi I Sektorit dhe ka këto detyra:

- ✓ Të zbatojë me korrektësi dhe përgjegjësi disiplinën.
- ✓ Futet në tubacione e puseta në rastet e bllokimit të linjave dhe heq mbeturinat me litar e me kova.
- ✓ Punon me mjete dore për të realizuar detyrat e tij si: me hekur DN 8 mm, me shat, me kovë, me ganxhë.
- ✓ Punojnë me kazëm e me lopatë në rastet e gërmimeve e cila ndodh në të gjitha llojet e bllokimeve.
- ✓ Punon në ambiente tejet të ndotura çdo ditë.
- ✓ Punon në thellësi të mëdha dhe në prezencë të agjentëve kimikë e bazikë të ndryshëm pa u trajtuar më parë edhe derdhjet e zonës spitalore
- ✓ Të zbatojë, brenda kriterëve të caktuara, të gjitha detyrat ditore që i ngarkohen nga eprori dhe të raportojë për realizimin e tyre.
- ✓ Të paraqitet në punë me bazën materiale të furnizuar nga shoqëria (veshmbathje dhe vegla pune).
- ✓ Të zbatojë në çdo kohë, me korrektësi të plotë, rregullat për masat e sigurimit teknik në punë.

Të njoftojë eprorin, për çdo problem që mund t'i lindë gjatë zbatimit të detyrës, dhe të ndjekë udhëzimet që i jepen nga eprori për vazhdimin e detyrës

Kandidatet duhet te plotesojne kerkesat e posaçme si vijon:

- ✓ Te jene shtetas shqiptare .
- ✓ Arsim I ulet ose I mesem.
- ✓ Te jene ne gjendje te mire shendetesore dhe te afte fizikisht.

DOKUMENTACIONI , MENYRA DHE AFATET E DOREZIMIT

1. CV
2. Fotokopje ID
3. Librezë Pune
4. Çertifikatë personale
5. Çertifikatë e gjendjes familjare
6. Diplome shkolle (e noterizuar)
7. Listë notash (e noterizuar)
8. Çertifikatë/ Dokument për kualifikime të ndryshme/Specializime
9. Dëshmi Penaliteti
10. Vertetim i Gjendjes Gjyqësore
11. Vertetim prokurorie
12. Saktësim adrese nga Bashkia
13. Raport Mjekoligjor (Aftësi në punë)
14. Foto të vogla (2 copë), foto e madhe (1 copë)

Afati i aplikimit 5 dite.

Kandidatet do te vleresohen ne lidhje me dokumentacionin e dorezuar.

Ne perfundim te vleresimit te kandidateve , Drejtoria e Burimeve Njerezore do te shpalle fituesit ne portalin “ Sherbimi Kombetar I Punesimit”, ne faqen e internetit.

Kandidatet jo fitues kane te drejte te ankimohen prane Drejtorise se Burimeve Njerezore . Afati I Ankimit eshte 3 (tre) dite nga data e shpalljes se fituesit.

